



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KRYETARI

Nr. 1824 Prot.

Patos, më 08/07 /2024



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM
Nr. 53, datë 08/07 /2024

PËR DISA NDRYSHIME NË LIDHJEN NR. 3 DHE 4 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 74 DATË 30.11.2023 "MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE NË VARTËSI, NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA PËR VITIN 2024"

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në nenin 54 shkronja "ç" të ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", V.K.M nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", V.K.M nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos që të miratojë disa ndryshime në VKB nr. 74, datë 30.11.2023 "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024", të cilat të jenë si vijon:

1. Lidhja 3 dhe 4 e VKB nr. 74, datë 30.11.2023 "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024" të ndryshoj me lidhjet me të njejtët numër 3 dhe 4.
2. Efekti financiar që lind nga ndryshimi i pagave për funksionet specifike të mbulohet nga transfertat sekroriale shtesë.
3. Zbatimi i këtij vendimi i shtrin efektet financiare nga data 01.07.2024.
4. Për zbatimin e këtij projektvendimi pas miratimit në Këshillin Bashkiak, ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës e cila do të bëjë shpërndarjen e këtij efekti për çdo program.

DREJTUESI I PROGRAMIT TË PLANIFIKIMIT, MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT

Juela Shpata



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KRYETARI

Lidhja 1



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

Niveli i pagave i punonjësve mësimor ndryshon si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Arsimi	Paga e Grupit/ Kategoria	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikimin	Shtesa e Pozicionit
	Drejtoreshë në kopshtin me ushqim	I Lartë	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	80 000
	Drejtoreshë në kopshtin pa ushqim	I Lartë	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	75 000
	Edukatore	I Lartë	1	2% e PG	5% e PG 10% e PG 20% e PG	58 000
	Drejtoreshë në Qendrën Kulturorë të Fëmijëve	I Lartë	1	2% e PG	5,10,20% e PG	99 500
	Përgjegjëse Sektori në QKF	I Lartë	1	2% e PG	5,10,20% e PG	73 000

DREJTUESI I PROGRAMIT TË ARSIMIT BAZË

Elda Goxhaj

DREJTUESI I PROGRAMIT TË PLANIFIKIMIT, MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT

Juela Shpata

PËRGJEGJËSE E SEKTORIT JURIDIK

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KRYETARI



Lidhja 2

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

Niveli i pagave i punonjësve të M.Z.Sh-së ndryshon si më poshtë:

Nr.	EMERTIMI	Niveli	Arsimi	Grada	Shtesa për natyrë të veçantë	Paga bazë e gradës
	Shefi i Sektorit	i mesëm	I larte	Kryeinspektor Zjarrfikës	6 000	85 000
	Inspektor parandalimi	Bazë	I larte	Inspektor Zjarrfikës	6 000	75 000
	Zjarrfikës	Bazë	I mesem	Kryezjarrfikës	8 000	70 000
	Zjarrfikës	Bazë	I mesem	Zjarrfikës	8 000	65 000
	Zjarrfikës	Bazë	I mesem	Asistent Zjarrfikës	7 000	60 000
	Shofer zjarrfikëse	Bazë	I mesem	Zjarrfikës	8 000	65 000

DREJTUESI I PROGRAMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN DHE MBROJTJES CIVILE

Alket Halimi

DREJTUESI I PROGRAMIT TË PLANIFIKIMIT, MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT

Juela Shpata

PËRGJEGJËSE E SEKTORIT JURIDIK

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE INFORMIMIT PUBLIK

Nr. 1824 Prot.

Patos, më 08/07/2024

RELACION SHPJEGUES

MBI PROJEKT-VENDIMIN PËR NDRYSHIM NË LIDHJEN NR. 3 DHE 4 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 74 DATË 30.11.2023 "MBI MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË INSTITUCIONEVE NË VARTËSI, NJËSIVE ADMINISTRATIVE DHE FUNKSIONEVE TË TRANSFERUARA PËR VITIN 2024".

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Kjo kërkesë për disa ndryshime në lidhjet 3 dhe 4 të VKB nr. 74, datë 30.11.2023 "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2024" vjen në bazë të ndryshimit të nivelit të pagave me V.K.M-në nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" dhe V.K.M-në nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar".

Për sa më sipër ftojmë Këshillin e Bashkisë Patos që të miratoj rritjen e nivelit të pagave të punonjësve të M.Z.Sh-së dhe punonjësve mësimor.

Faleminderit!

DREJTORE
Juela Shpata

KRYETARI
Fation Duro

